



Prishtinë, 17 dhjetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1466_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenit 30, Nenit 32 paragrafin 2, nënparagrafi 2.1, Nenit 34 dhe Nenit 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 6 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Nr.07/2017);
- "Marrëveshjen për Blerje të Energjisë (MBA) për Kapacitetet Gjeneruese nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë, mbështetur nga Rregulla për Skemën Mbështetëse", të lidhur me datë 03.09.2019 në mes ndërmarrjes SOWI KOSOVO L.L.C, WIND PARK "SELAC 3" dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A, të datës 03.09.2019; si dhe
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Prodhimit të Energjisë Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 13.07.2021 nga ndërmarrja SOWI KOSOVO L.L.C., adresa Rr. Mujo Ulqinaku, Nr.12, 10000 Prishtinë (Lokacioni ZK Selac Mitrovicë), Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 17 dhjetor 2021, nxori këtë:

VENDIM

- I. **I LËSHOHET LICENCA** për prodhim të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë nga Parku me Erë "SELAC 3", ndërmarrjes SOWI KOSOVO L.L.C, me numër licence ZRRE/Li_82/21, për periudhën prej dyzet (40) vitesh, nga data 17.12.2021 deri me datë 16.12.2061.
- II. **Obligohet** ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për SOWI KOSOVO L.L.C, të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 13.07.2021 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë nga Ndërmarrja SOWI KOSOVO L.L.C, nga gjeneratori WIND PARK SELAC-3, me kapacitet të instaluar prej 34.47 MW .
- o Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duke dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
- o Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja SOWI KOSOVO L.L.C. me datë 13.12.2021 ka njoftuar palët e interesit përmes gazetave elektronike, se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të



prodhimit të energjisë elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim nga palët e interesit, për këtë aplikacion.

- Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- Bordi i Rregullatorit ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike dhe legjislacionit tjetër në fuqi. Kështu duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- Licenca e lëshuar do të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se **gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 25 të Licencës së lëshuar nga Rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.


Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

***bashkëngjitur licenca**

Vendimi i dërgohet:


- Ndërmarrjes SOWI KOSOVO L.L.C,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar